

# **IKAF AC-P7 Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia**

## **Syllabus dhe Udhëzues Studimi**

*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar*  
*(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

### **Struktura e Kualifikimit**

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

### **Moduli**

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

### **Struktura e Syllabusit**

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia i cili është pjesë e nivelit Auditor i Jashtëm i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

### **Udhëzuesi i Studimit**

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimëve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuar në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


## STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar  
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Auditori i Certifikuar fillimisht duhet të kualifikohet si Kontabilist i Certifikuar në IKAF. Jo për të gjithë Kontabilistët e Certifikuar kërkohet ose është e nevojshme të kualifikohen Auditor të Certifikuar, me përjashtim të rastit nëse ata zgjedhin një karrierë në ofrimin e auditimeve ligjore dhe shërbimeve përkatëse. Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) licencon Auditorët në Kosovë dhe roli i IKAF-it është për të siguruar se ata janë të certifikuar në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Edukimit, Direktivën e 8 të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në vitet e fundit standardet e edukimit dhe kërkesat e praktikës profesionale për Auditorët Ligjor janë përditësuar, andaj skema e re e kualifikimit në IKAF ka për qëllim të sigurojë që auditorët e Kosovës janë të kualifikuar me standardet më të larta ndërkombëtare.

Për të u trajnuar për kualifikim si Auditor i Certifikuar, ju së pari duhet të jeni anëtar i IKAF dhe të keni përfunduar kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar. Anëtarësia në këtë nivel është e hapur për të gjithë profesionistët që punojnë në kontabilitet dhe auditim dhe të cilët kanë përfunduar nivelin për Kontabilist të Certifikuar.


Kandidatët në Kualifikimin për Auditor i Jashtëm i Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulën “Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia”.



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Auditor i Jashtëm i Certifikuar

## Modulet

Kualifikimi Auditor i Jashtëm i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Auditor i Jashtëm i Certifikuar

### **KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE ANETARESIMIT: Auditor i Jashtëm i Certifikuar**

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Kontabilistë të Çertifikuar;
- Dëshmi mbi përvojën e punës 3 vite në auditim apo kontabilitet;
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nëse arrihet 50% e pikeve në test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Auditori i Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt në IKAF për ta përdor titullin “Auditori i Çertifikuar” e kanë obligative ndjekjen e edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP/CPD) të percaktuara edhe në rregullore

### **Karakteristikat e ligjerates trajnuese:**

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve, dhe gjatë ligjerates, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjeresit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushën e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trajnues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë të gatshëm të nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

# **STRUKTURA E SYLLABUSIT**

## **Arsyetimi**

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

## **Diagrami i relacioneve mes moduleve**

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

## **Qëllimi**

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

## **Aftësitë kryesore**

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

## **Temat**

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

## **Struktura e Ekzaminimit**

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi

## **Shtojcë Syllabusi i Detajuar**

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

# MODULI

## Arsyetimi

Syllabusi i Auditimit të Avancuar dhe Siguridhënies në thelb është i ndarë në shtatë fusha.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e Moduleve

Syllabusi fillon me parimet ligjore dhe mjedisin rregullator, duke përfshirë pastrimin e parave dhe parimet profesionale dhe etike, duke përfshirë kodin e etikës dhe përgjegjësinë profesionale. Kjo pastaj çon në procedurat e menaxhmentit në praktikë, duke përfshirë kontrollin e cilësisë dhe pranimin dhe mbajtjen e angazhimit profesional.

Planprogrami pastaj mbulon auditimin e pasqyrave financiare, duke përfshirë planifikimin, evidencat dhe rishikimin. Ai pastaj mbulon detyra të tjera, duke përfshirë informacionin e ardhshëm financiar, si dhe detyra të tjera të siguridhënies, si dhe raportimin e këtyre detyrave.

Pjesa e fundit mbulon çështjet dhe zhvillimet aktuale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe siguridhënies.

## Qëllimi

Për të analizuar, vlerësuar dhe konkluduar angazhimin e siguridhënies dhe çështjeve të tjera të auditimit dhe të siguridhënies në kontekstin e praktikave më të mira dhe zhvillimeve aktuale.


## Aftësitë kryesore

- Njohin mjedisin ligjor dhe rregullator dhe ndikimin e tij praktikën e auditimit dhe siguridhënies
- Demonstrjnë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një angazhim të siguridhënies apo shërbimi tjetër brenda një kuadri profesional dhe etik
- Vlerësojnë dhe rekomandojnë kontroll të duhur të cilësisë dhe procedurat e menaxhmentit dhe të njohin pozitën e auditorit për pranimin dhe mbajtjen e emërimeve profesionale
- Identifikojnë dhe formulojnë punën e nevojshme për të përmbushur objektivat e auditimit dhe të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- Vlerësojnë gjetjet dhe rezultatet e punës së kryer dhe të hartojnë raporte të përshtatshme lidhur me detyrat

- Kuptojnë çështjet aktuale dhe zhvillimet lidhur me sigurimin e shërbimet të auditimit dhe siguridhënies
- Kuptojnë çështjet dhe zhvillimet aktuale në lidhje me sigurimin e shërbimet të auditimit dhe siguridhënies.

## Temat

Temat kryesore të Modullit Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia që do të trajtohen gjatë ligjërates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Auditimi i Avancuar dhe Siguridhënia

## Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

## Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

## Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

## **Syllabusi i Detajuar**

### **A Mjedisi Rregullator**

1. Kornizat rregullatore ndërkombëtare për shërbime të auditimit dhe siguridhënies
2. Shpërlarja e parave
3. Ligjet dhe rregulloret

### **B Parimet Profesionale dhe etike**

1. Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionistë
2. Mashtrimi dhe Gabimi
3. Detyrimi Profesional

### **C Menaxhmenti në Praktikë**

1. Kontrolli i cilësisë
2. Reklamat, publiciteti, bërja e punës profesionale dhe tarifat
3. Tenderimi
4. Emërimet profesionale

### **D Auditimi i Informatave Financiare Historike**

1. Planifikimi, materialiteti dhe vlerësimi i rrezikut të keqdeklarimit
2. Evidenca

3. Vlerësimi dhe rishikimi
4. Auditimet në grup

### **E Detyrat e tjera**

1. Shërbimet e auditimit
2. Shërbimet e siguridhënies
3. Informacioni i ardhshëm financiar
4. Auditimet e Mjekësisë Ligjore
5. Auditimi i brendshëm
6. Delegimi

### **F Raportimi**

1. Raporet e auditorit
2. Raportet për ata të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhim
3. Raportet e tjera

### **G Çështjet dhe zhvillimet aktuale**

1. Profesionale dhe Etike
2. Teknologjia e informacionit
3. Auditimet transnacionale
4. Auditimi social dhe mjedisor
5. Çështje të tjera aktuale

## Udhëzues Studimi

### A Mjedisi Rregullator

#### 1. Kornizat rregullatore ndërkombëtare për shërbime të auditimit dhe siguridhënies

- Të shpjegohet nevoja për ligjet, rregulloret, standardet dhe udhëzues të tjerë që lidhen me auditimin, siguridhënien dhe shërbimet.
- Të përkufizohet dhe shpjegohet nevoja për kornizën ligjore dhe profesionale, duke përfshirë:
- Mbikqyrja publike e një praktike të auditimit dhe siguridhënies
- Roli i komisioneve të auditimit dhe ndikimi në praktikën e auditimit dhe siguridhënies

#### 2. Shpërlarja e parave

- Të definohet „shpërlarja e parave“.
- Të shpjegohet se si përpjekjet ndërkombëtare kërkojnë të luftojnë pastrimin e parave.
- Të përshkruhet fushëveprimi i veprave penale të pastrimit të parave dhe se di kontabilistët profesional mund të mbrohen nga detyrimet kriminale dhe civile.
- Të shpjegohet nevoja për udhëzues etik në këtë fushë.
- Të përshkruhet se si kontabilistët përmbushin detyrimet e veta për të ndihmuar në parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave duke përfshir regjistrimin dhe raportimin e

dyshimeve tek organi i duhur rregullator.

- Të shpjegohet rëndësia e verifikimit të identitetit të konsumatorit.
- Njohja e transaksioneve potencialisht të dyshimta dhe vlerësimi i impaktit të tyre në detyrat e raportimit.
- Të përshkruhen, me arsye, elementet themelore të programit për anti-pastrimit të parave.

#### 3. Ligjet dhe rregulloret

- Të krahasohen përgjegjësitë respective të menaxhmentit dhe auditorëve lidhur me përputhjet me ligjet dhe rregulloret në një auditim pasqyrave financiare.
- Të përshkruhen parimet e auditorëve rreth përputhjes me ligjet dhe rregulloret dhe të planifikohen procedurat e auditimit kur të zbulohen mos-përputhjet e mundshme.
- Të diskutohet si dhe tek kush duhet raportuar mos-përputhjet.
- Të njihet kur një tërheqje nga një angazhim është i nevojshëm.

### B Parimet Profesionale dhe etike

#### 1. Kodi i Etikës për Kontabilistët Profesionalistë

- Të shpjegohen parimet themelore dhe qasjen e kornizës konceptuale.
- Të identifikohen, vlerësohen dhe përgjigjen kërcënimet për përputhje me parimet themelore.



- Të diskutohet dhe vlerësohet efektiviteti i masave mbrojtëse në dispozicion.
- Të njihet dhe këshillohet mbi konfliktet në aplikimin e parimeve themelore.
- Të diskutohet rëndësia e skepticizmit profesional në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi.
- Të vlerësohet nëse një angazhim është planifikuar dhe kryer me një qëndrim të skepticizmit profesional, dhe të vlerësohen implikimet.

## 2. Mashtrimi dhe Gabimi

- Të definohet dhe në mënyrë të qartë të bëhet dallimi në mes të termave „gabim“, „parregullsi“, „mashtrim“ dhe „keqdeklarim“.
- Të krahasohen përgjegjësitë e menaxhmentit dhe auditorëve për mashtrim dhe gabim.
- Të përshkruhet çështjet që duhet patur parasyshë dhe procedurat që duhet kryhen për të hetuar keqdeklarimet real dhe/ose potenciale në një situatë të dhënë.
- Të shpjegohet se si, pse, kur dhe kujt duhet t'i raportohet mashtrimi dhe rrethanat në të cilat një auditor duhet të tërhiqet nga angazhimi

## 2. Detyrimi Profesional

- Të njihen rrethanat në të cilat kontabilistët profesional mund të kenë detyrim ligjor.

- Të përshkruhen faktorët për të përcaktuar nëse është apo jo një auditor neglizhentë në situatat e dhëna.
- Të shpjegohet kriteri tjetër që duhet njohur për detyrimin ligjor (përfshir „kujdesin e duhur profesional“ dhe „afërsinë“) dhe të aplikohen ato në situatat e dhëna.
- Të krahasohet detyrimi ndaj klientit me detyrimin ndaj palës së tretë.
- Të vlerësohet praktikiteti dhe efektiviteti i mënyrave sipas të cilave mund të kufizohet detyrimi.
- Të diskutohen marrëveshjet e kufizimit të detyrimit.
- Të diskutohen dhe vlerësohen shkaqet kryesore të dështimit të auditimit dhe faktorëve të tjerë që kontribuon në „hapësirën e pritshme“ (psh. përgjegjësitë për mashtrim dhe gabim).
- Të rekomandohen mënyrat në të cilat mund të mbushet hapësira e pritshme.

## C Menaxhmenti në Praktikë

### 1. Kontrolli i cilësisë

- Të shpjegohen parimet dhe qëllimi i kontrollit të cilësisë të auditimit dhe angazhimeve të tjera të
- Të përshkruhen elementet e një sistemi të kontrollit të cilësisë relevante për një firmë.
- Të përzgjedhen dhe arsyetohen procedurat e kontrollit të cilësisë që janë të aplikueshme për një angazhim të auditimit.
- Të vlerësohet nëse është planifikuar dhe kryer një angazhim në përputhje me

standardet profesionale dhe nëse raportet e lëshuara janë të duhurat për rrethanat.

## **2. Reklammat, publiciteti, bërja e punës profesionale dhe tarifat**

- Të njihen situatat në të cilat janë të pranueshme reklammat specifike.
- Të diskutohen kufizimet në përshkrimet e praktikës, përdorimi i logos së AACA dhe emrat e firmave.
- Të diskutohet shkalla në të cilën mund të përcaktohet tarifa në materialet promociionale.
- Të përkufizohen përcaktuesit e tarifës dhe të arsyetohen bazat në të cilat tarifat mund ose nuk mund të ngarkohen për shërbime.
- Të diskutohen problemet etike dhe problemet e tjera profesionale, të përfshira në themelimin dhe negociimin e tarifave për një marrëveshje specifike.

## **3. Tenderimi**

- Diskutimi i arsyeve pse njësitë ndryshojnë auditorët/kontabilistët profesional.
- Njohja dhe shpjegimi i çështjeve që duhet marrë parasysh kur një firmë ftohet të dorëzojë një propozim ose një kuotë tarifore për një auditim ose për ndonjë angazhim tjetër profesional.
- Identifikimi i informacionit që duhet përfshirë në një propozim.

## **4. Emërimet profesionale**

- Shpjegimi i çështjeve dhe procedurave që duhet marrë parasysh të cilat një firmë/kontabilist profesional duhet kryer para pranimit të një klienti/angazhimi të veçantë, përfshirë:
  - pranimin e klientit
  - pranimin e angazhimit
  - përcaktimi se a janë të pranishme parakushtet për një auditim
  - dakordimi i kushteve të angazhimit.
- Njohja e çështjeve kyçe që nënvizojnë marrëveshjen e një fushëveprimi dhe kushtëtet e një angazhimi me një klient.

## **D Auditimi i Informatave Financiare Historike**

### **1. Planifikimi, materialiteti dhe vlerësimi i rrezikut të keqdeklarimit**

- Definimi i materialitetit dhe materialitetit të performacës dhe demonstrimi se si duhet të zbatohet në raportimin financiar dhe auditim
- Identifikimi dhe shpjegimi i rreziqeve të biznesit për një detyrë të dhënë.
- Identifikimi dhe shpjegimi i rreziqeve të auditimit për një detyrë të dhënë
- Identifikimi dhe shpjegimi i rreziqeve të keqdeklarimit material në planifikimin e një detyre.
- Diskutimi dhe demonstrimi i përdorimit të procedurave analitike në planifikimin e një detyre.
- Shpjegimi si si rezultati i planifikimit të procedurave përcakton strategjinë relevante të auditimit.

- Shpjegimi i procedurave të planifikimit specifike për një angazhim të auditimit.
- Identifikimi i informacionit shtesë që mund të kërkohet në mënyrë që të planifikohet më efektisht një detyrë.
- Njohja e çështjeve që nuk janë relevante në planifikimin e një detyre.

## 2. Evidenca

- Identifikimi dhe shpjegimi i procedurave të auditimit për të marrë evidencë të mjaftueshme të auditimit nga burimet e identifikuar.
- Identifikimi dhe vlerësimi i evidencave të auditimit që priten të jenë në dispozicion për:
  - mbështetjen e deklarimeve në pasqyrën financiare dhe trajtimeve kontabël (përfshirë vlerat e drejta)
  - mbështetjen e shpalosjeve të bera në shënimet në pasqyrat financiare.
- Aplikimi i procedurave analitike në të dhënat financiare dhe jo-financiare.
- Shpjegimi i problemeve dhe procedurave specifike të auditimit lidhur me palët e lidhura dhe përzgjedhja e procedurave përkatëse të auditimit.
- Njohja e rrethanave që mund të tregojnë ekzistencën e palëve të lidhura të paidentifikuara dhe përzgjedhja e procedurave përkatëse të auditimit.
- Vlerësimi i përdorimit të përfaqësimeve të shkruara të menaxhmentit për të mbështetur evidencat e tjera të auditimit.
- Njohja kur është e arsyeshme të vendoset mbështetje në punën e një eksperti.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së punës së auditorëve të

brendshëm dhe masa në të cilën mund të vendoset mbështetja.

## 3. Vlerësimi dhe rishikimi

- Vlerësimi i çështjeve (psh. materialiteti, rreziku, standardet relevante kontabël, evidencat e auditimit) lidhur me:
  - kontrata e stokut dhe ndërtimit
  - Sistemet standarde të kostimit
  - pasqyra e rrjedhës së parasë
  - ndryshimet në politikat kontabël
  - tatimet (përfshirë tatimet e shtyra)
  - raportimi i segmentit vii. asetet jo-qarkulluse viii. vlera e drejtë
  - qiratë
  - njohja e të ardhurave
  - përfitimet e punonjësve xii. grantet qeveritare
  - palët e lidhura
  - fitimet për aksion
  - zhvlerësimi
  - provizionet, detyrimet kontigjente dhe asetet kontigjente
  - Asetet e pa-prekshme
  - instrumentet financiare
  - pronat investuese
  - transaksionet e pagesave të bazuara në aksione
  - kombinimet e biznesit
  - astet të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera
  - Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese
  - efektet e kursit të këmbimit të huaj xxv. kostot e huamarrjes
- Shpjegimi i përdorimit të procedurave analitike në vlerësim dhe rishikim

- Shpjegimi se si realizohen përgjegjësitë e auditorit për shifrat korrenspoduse, pasqyrat krahasuese financiare dhe 'informacionet e tjera'.
- Aplikimi i konsideratave të mëtejshme dhe procedurave të auditimit relevante për angazhimet fillestare
- Diskutimi i rrjedhës së veprimit në dispozicion të auditorit nëse një mospërputhje apo keqdeklarim i faktit ekziston në lidhje me informacionet e tjera.
- Specifikimi i procedurave të auditimit të hartuara për të identifikuar ngjarjet e mëvonshme që mund të kërkojnë përshtatje, ose shpalosje në pasqyrat financiare të një njësie të caktuar.
- Identifikimi dhe shpjegimi i treguesve që baza e vijimësisë mund të jetë në dyshim dhe njohja faktorëve lehtësues.
- Rekomandimi i procedurave të auditimit, apo vlerësimi i evidencave që mund të priten të jenë në dispozicion dhe vlerësimi i përshtatshmërisë të bazës së vijimësisë në situata të caktuara.
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së shpalosjeve në pasqyrat financiare që lidhet me vijimësinë dhe shpjegimi i implikimeve për raportin e auditorit në lidhje me baza e vijimësisë
- Identifikimi dhe shpjegimi i çështjeve specifike për të planifikuar një auditim të pasqyrave financiare të grupit, përfshirë vlerësimin e grupit dhe komponentin material, ndikimin përmbylljes jo të njejtë të vitit brenda një grupi, dhe ndryshimet në strukturën e një grupi.
- Arsyetimi i situatave kur një auditim i përbashkët do të jetë i duhur.
- Njohja e problemeve të auditimit dhe përshkrimi i procedurave të auditimit specifike pëe një kombinim të biznesit, përfshir goodëill, politikat kontabël, tregtimit ndërmjet ndërmarrjeve, klasifikimi i investimeve, ontabiliteti i kapitalit (ekuitetit) për bashkëpunëtorët, ndryshimet ne strukturës e grupit, si dhe kontabiliteti për filialet e huaja.
- Identifikimi dhe shpjegimi i rreziqeve të auditimit, dhe procedurat e nevojshme të auditimit relevante për procesin e konsolidimit.
- Identifikimi dhe përshkrimi i çështjeve që duhet konsideruar dhe procedurat që duhet kryer në fazën e planifikimit, kur auditori kryesor konsideron përdorimin e punës së auditorëve komponentë.
- Konsiderimi se si auditori kryesor do të vlerësojnë punën audituese të kryer nga një auditor komponent.
- Shpjegimi i implikimeve për raportin e auditorit në pasqyrat financiare të një njësie ku opinionin në një komponenti është i kualifikuar ose ndryshe i modifikuar në një situatë të caktuar

#### **4. Auditimet në grup**

- Njohja e çështjeve specifike që duhen konsideruar para pranimit të një emërimi si auditor kryesor i një grupi në situaën në fjalë.

## **E Detyrat e tjera**

### **1. Shërbimet e auditimit**

- Përshkrimi i natyrës së shërbimeve të lidhura të auditimit, rrethant në të cilat mund të kërkohen ato dhe nivelet krahasuese të sigurimit, të ofruara nga kontabilistët profesionis dhe dallimin në mes:

i. shërbimet e lidhura të auditimit dhe një auditimit të pasqyrave financiare historike

ii. një vërtetim i angazhimit dhe një angazhim i drejtpërdrejtë i raportimit

- Angazhimet e rishikimi të planit, për shembull:

i. një rishikim i informacionit të përkohshëm financiar

ii. një detyrë „e një analize dhe hulumtimi të thellë“ (Kur blehet një kompani, biznes apo asete të tjera).

- Shpjegimi i rëndësisë së hetimit dhe procedurave analitike në angazhimet e rishikimit dhe aplikimi i këtyre procedurave.

### **2. Shërbimet e siguridhënies**

- Përshkrimi i kategorive të shërbimeve të siguridhënies që firmat e auditimit mund të ofrojnë dhe vlerësojnë fitimet e ofrimit të këtyre shërbimeve për menaxhmentin dhe përdoruesit e jashtëm.

- Justifikimi i një niveli të siguridhënies (i arsyeshëm, i lartë, i moderuar, i kufizuar, negativ) për një angazhim në varësi të lëndës vlerësuar, kriteret e përdorura, procedurat e aplikuara dhe cilësinë dhe sasinë e evidencave të marra.
- c) Njohja e mënyrave në të cilat lloje të ndryshme të rrezikut (p.sh. strategjik, operues, informacionit) mund të identifikohen dhe analizohen dhe vlerësimi se si menaxhmenti duhet të reagoj ndaj rrezikut.

### **3. Informacioni i ardhshëm financiar**

- Përkufizimi i „informatave të ardhshme financiare“ (IAF) dhe dallimi në mes të një „parashikimi“, një projektimi, një 'ilustrimi hipotetik' dhe një 'targeti'.
- Shpjegimi i parimeve të dobishme të IAF.
- Identifikimi dhe përshkrimi i çështjeve që duhet konsideruar para pranimit të një angazhimi të veçantë për të raportuar mbi IAF.
- Diskutimi i nivelit të sigurimit që auditori mund të ofrojë dhe shpjegimi i faktorëve të tjerë që merren parasysh në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të projektimit.
- Përshkrimi i procedurave të shqyrtimit për të verifikuar parashikimet dhe projektimet.
- Krahasimi i përmbajtjes së një raporti në shqyrtimin e IAF me raportet e bëra në ofrimin e shërbimeve të lidhura të auditimit.

#### 4. Auditimet e Mjekësisë Ligjore

- Përkufizimi i termeve 'kontabiliteti ligjor', 'hetimi ligjor' dhe 'auditimi ligjor'.
- Përshkrimi i aplikimeve kryesore të auditimit ligjor (psh. mashtrimi, neglizhenca, paditë për sigurime) dhe analizimi i rolit të auditorit ligjor si dëshmitar ekspert.
- Aplikimi i parimeve themelore etike për kontabilistët profesionist të angazhuar në detyrat e auditimit ligjor.
- Planifikimi i angazhimit të auditimit ligjor.
- Përzgjedhja e procedurave hetimore dhe vlerësimi i evidencave të përshtatshme për përcaktimin e humbjeve në një situatë të caktuar

#### 5. Auditimi i brendshëm

- Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të një departamenti të auditimit të brendshëm në planifikimin dhe performancën e auditimit të jashtëm.
- Shpjegimi i përfitimeve dhe disavantazheve të mundshme të outsourcing (shfrytëzimi i burimeve të jashtme) të auditimit të brendshëm.
- Konsiderimi i implikimeve etike të auditorit të jashtëm i cili ofron shërbim të auditimi të brendshëm për një klient.

#### 6. Delegimi

- Shpjegimi i qasjeve të ndryshme ndaj „outsourcing“ shfrytëzimi i burimeve të jashtme)“ dhe krahasimi me „insourcing (shfrytëzimi i burimeve të brendshme)“.

- Diskutimi dhe konkludimi mbi avantazhet dhe disavantazhet e outsourcing të funksioneve të financave dhe kontabilitetit.
- Njohja dhe vlerësimi i ndikimit të funksioneve outsourced (transferuara) në kryrjen e një auditimit.

## F Raportimi

### 1. Raporet e auditorit

- Vlerësimi në mënyrë kritike i formës dhe përmbajtjes së raportit të një auditori në një situatë të caktuar.
- Njohja dhe vlerësimi i faktorëve që duhet të merren parasysh kur të formohet një opinion i auditimit në një situatë të caktuar dhe arsyetimi i opinioneve të auditimit që janë në përputhje me rezultatet e procedurave të auditimit.
- Vlerësimi nëse një opinion i auditimit është i përshtatshëm apo jo.
- Këshillimi mbi veprimet që mund të ndërmerren nga auditori në rast se lëshohet një raport i modifikuar i auditimit.
- Të kuptuarit kur përdorimi i një paragrafi të theksimit të çështjes dhe paragrafit të çështjes tjetër do të jetë i përshtatshëm.
- Diskutimi i çështjeve të tjera aktuale ligjore, etike, çështje të tjera profesionale dhe praktike që prekin kontabilistët, auditorët, punëdhënësit e tyre dhe profesionin.

## **2. Raportet për ata të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhim**

- Vlerësimi në mënyrë kritike i cilësisë së raporteve për ata të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhim.
- Këshillë mbi përmbajtjen e raporteve për ata të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhimin në një situatë të caktuar

## **3. Raportet e tjera**

- Analizimi i formës dhe përmbatjes së raportit të kontabilistit profesionist për një angazhim të siguridhënies në krahasim me një raport të auditorit.
- Diskutimi i përmbajtjes së raportit rreht shqyrtimit të informacionit të ardhshëm financiar.
- Diskutimi i efektivitetit të formës së raportimit të „siguridhënies negative“ dhe vlerësimi i situatave në të cilat mund të jetë e përshtatshme për të shprehur një rezervë ose të mohohet një konkluzion.

## **G Çështjet dhe zhvillimet aktuale**

### **1. Profesionale dhe Etike**

- Diskutimi i avantazheve relative të një kornize etike dhe një rregullore.
- Identifikimi dhe qasja e çështjeve relevante etike në zhvillim dhe vlerësimi i masave mbrojtëse në dispozicion.
- Diskutimi i zhvillimeve IFAC.

## **2. Teknologjia e informacionit**

- Përshkrimi i tendencave të fundit në TI dhe impakti i tyre potencial dhe aktual mbi auditorët (psh. implikimet e auditimit të „incidenteve kibernetike“ dhe rreziqeve të tjera)
- Shpjegimi se si TI mund të përdoret për të ndihmuar auditorët dhe diskutimi i problemeve të cilat mund të hasen në automatizimin e procesit të auditimit

## **3. Auditimet transnacionale**

- Përkufizimi i „Auditimeve transnacionale“ dhe shpjegimi i rolit të Komisionit Transnacional të Auditimit (KAT) të IFAC.
- Diskutimi se si auditimet transnacionale mund të dallojnë nga auditimet e tjera të informacionit historic financiar (psh. sa i përket standardeve të zbatueshme të raportimit dhe auditimit financiar, kërkesat e listuara dhe kërkesat e qeverisjes së korporatave).

## **4. Auditimi social dhe mjedisor**

- Planifikimi i një angazhimi për të siguruar siguri mbi matjet e performancës dhe treguesve të qëndrueshmërisë.
- Përshkrimi i vështirësive në matjen dhe raportimin mbi performancën ekonomike, mjedisore dhe sociale dhe dhënia e shembujve të masave të performancës dhe treguesve të qëndrueshmërisë.
- Shpjegimi i konsideratave kryesore të auditorit në lidhje me çështjet sociale dhe mjedisore dhe si ato ndikojnë në

subjektet dhe pasqyrat e tyre financiare (p.sh. nga zhvlerësimi i aseteve provizioneve dhe detyrimeve kontigjente).

- Përshkrimi i procedurave thelbësore për të zbuluar keqdeklarimet e mundshme në lidhje me çështjet socio-mjedisore.
- Diskutimi i formës dhe përmbajtjes së një deklarate të pavarur të verifikimit (p.sh.

në një sistem të menaxhimit të mjedisit (EMS) dhe një raport për shoqërinë).

## **5. Çështje të tjera aktuale**

- Shpjegimi i zhvillimeve aktuale në standardet e auditimit, duke përfshirë nevojën për standardet e reja dhe të rishikuara dhe vlerës